



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 50, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I NDËRTESES EKZISTUESE DHE NGRITJE KATESH NË
OBJEKTIN EKZISTUES”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TROPOJË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Marrveshjes për delegimin e kompetencave datë 07.08.2020, me propozim të zhvilluesit Z. Avni Ponari, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksion i ndërtesës ekzistuese dhe ngritje katesh në objektin ekzistues”, me vendndodhje në Bashkinë Tropojë, me zhvillues Z. Avni Ponari, të miratuar me vendimet e Bashkisë Tropojë Nr.8, datë 17.10.2017 dhe Nr. 1, datë 11.02.2019, si dhe me Vendimin Nr. 35, datë 14.10.2020, të Këshillit Kombëtar të Territorit, në përputhje me Marrëveshjen për Delegim të Kompetencave, të nënshkruar më datë 07.08.2020.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Tropojë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURAJI



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 28/05 2025